



KOLANA: DOKUMENTET E KISHËS KATOLIKE

1. Karta e të Drejtave të Familjes
2. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio*)
(Papa Gjon Pali II)
3. Kisha nga Eukaristia (*Ecclesia de Eucharistia*)
(Papa Gjon Pali II)
4. Për Risi - (*Rerum Novarum*) -Papa Leoni XIII
5. Paqja në Tokë (*Pacem in Terris*)-Papa Gjon XXIII
6. Hyji është Dashuri (*Deus caritas est*)-
(Papa Benedikti XVI)
7. Zhvillimi i popuive (*Populorum Progressio*)
(Papa Pali VI)
8. Besimtarët laikë të Krishtit (*Christifideles laici*)
(Papa Gjon Pali II)
9. Sakramenti i dashurisë (*Sacramentum Caritatis*)
(Papa Benedikti XVI)
10. Lufta kundër korrupsionit
11. Dashuria në të Vërtetën (*Caritas in Veritate*)
(Papa Benedikti XVI)
12. Dinjiteti i Gruas (*Mulieris Dignitatem*)
(Papa Gjon Pali II)
13. Fjala e Zotit (*Verbum Domini*)
14. Dhuratë dhe Mister (*Papa Gjon Pali II*)
15. Evangelii Nuntiandi (*Papa Pali VI*)
16. Novo Millennio Ineunte (*Papa Gjon Pali II*)

17. Besoj. Koment i shkurtër i Besojmës Apostolike (*Imzot Angelo Massafra*)
18. Lumen Fidei - Drita e Fesë (*Papa Françesku*)
19. Gëzimi i Ungjillit - *Evangelii Gaudium* (*Papa Françesku*)
20. Bashkësia Familjare - *Familiaris Consortio* (*Ribotim*)(*Papa Gjon Pali II*)
21. Fytyra e Mëshirës - *Misericordie Vultus* (*Papa Françesku*)
22. Ti qofsh lëvduar - (*Laudato si'*) (*Papa Françesku*)
23. Do t'ju jap barinj - (*Pastores dabo vobis*) (*Papa Gjon Pali II*)
24. Gëzimi i dashurisë - (*Amoris Laetitia*) (*Papa Françesku*)
25. Mëshira dhe mëkatarja-(*Misericordia et misera*) (*Papa Françesku*)
26. Emri i Zotit është Mëshirë - (*Papa Françesku*)
27. Humanae Vitae - (*Jeta njerëzore*) (*Papa Pali VI*)
28. Misteri dhe dinjiteti i gruas (*Sh. Gjon Pali II*)

Sh. GJON PALI II

MISTERI DHE DINJITETI
I GRUAS



Nën kujdesin
e Arqipeshkvisë Shkodër - Pult
Prill 2018

SH. GJON PALI II

Misteri dhe dinjiteti i gruas

Përkthimi në gjuhën shqipe i LETRËS

DREJTUAR GRAVE (1995)

Me disa tekste nga *Mulieris dignitatem* (1988)

Dom C. Lorenzo Rossetti

Red. Mr. Ermira Koleci/ Mr. Judita Marku

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Ioannes Paulus II, PP

Misteri dhe dinjiteti i gruas / Gjon Pali II ; përkth.
nga Lorenzo Rossetti; red. Ermira Koleci, Judita
Markui. – Shkodër: Arqipeshkvia Metropolitane
Shkodër-Pult, 2018

48 f. ; 14 cm. – (Kolana "Dokumentet e Kishës Ka-
tolike")

Marrë nga origj.: La letera alla donne (1995)

ISBN 978-9928-4449-5-0

1.Kisha katolike 2.Gra 3.Doktrina fetare
272 -1 272 -45

Në kopertinë: detaj nga Shkolla e Botticelli-it: Vir-
gjëra me fëmijën, një engjëll dhe sh. Gjoni.

Shkurtesat:

GS = Koncili Vatikani II, *Gaudium et spes* (1965)

LG = Koncili Vatikani II, *Lumen gentium* (1964)

MD = Gjon Pali II, *Letra Mulieris dignitatem* (1992)

LETRA DREJTUAR GRAVE (1995)

Juve, o gra të të gjithë botës, përshëndetja ime më e përzemërt!

1. Secilit prej jush dhe të gjitha grave të botës, u adresohet kjo letër si shenjë bashkëndarjeje dhe mirënjohjeje... Unë do të doja t'i flisja direkt çdo gruaje, për të reflektuar me të mbi problemet dhe perspektivat e statusit të gruas në kohën tonë, duke theksuar në veçanti çështjen thelbësore të dinjitetit dhe të drejtave të grave, duke i konsideruar në dritën e Fjalës së Perëndisë.

Pika e fillimit për këtë dialog ideal mund të jetë vetëm falënderimi. Kisha «dëshiron të falënderojë Trininë e Shenjtë për 'misterin e gruas' dhe për çdo grua, për çdo gjë, që përbën masën e përjetshme të dinjitetit të saj femëror, për 'veprat e mëdha të Perëndisë', të cilat në historinë e breznive njerëzore janë kryer në të dhe nëpërmjet saj» (MD 31).

[Falënderimi]

2. *Falënderimi* ndaj Zotit për synimin e tij në thirrjen dhe misionin e grave në botë, bëhet edhe një falënderim konkret dhe i drejtpërdrejtë ndaj grave, ndaj çdo gruaje, për atë që përfaqëson në jetën e njerëzimit.

Faleminderit, *grua-nënë!* Ti, që bëhesh kraharor i qenies njerëzore në gëzimin dhe travajin e një përvoje unike, që bëhesh buzëqeshja e Perëndisë për fëmijën që vjen në dritë, ti që drejton hapat e tij të parë, mbështetje e rritjes së tij, pikë referimi në udhëtimin e ardhshëm të jetës.

Faleminderit, *grua-bashkëshorte!* Ti që e bashkon në mënyrë të pakthyeshme fatin tënd me atë të një burri, në një marrëdhënie me dhuratë të ndërsjellë, në shërbim të bashkimit dhe të jetës.

Faleminderit, *grua-bijë* dhe *grua-motër!* Ti që sjell në bërthamën familjare dhe pastaj në gjithë jetën shoqërore pasuritë e ndjeshmërisë sate, intuitën tënde, bujarinë tënde dhe qëndrueshmërinë tënde.

Faleminderit, *grua-punëtore!* Ti që je e angazhuar në të gjitha sferat e jetës sociale,

ekonomike, kulturore, artistike, politike, për kontributin jetik për zhvillimin e një kulture, e cila bashkon arsyen dhe ndjenjat, në një konceptim të jetës gjithmonë të hapur ndaj ndjenjës së "misterit", për ndërtimin e strukturave ekonomike dhe politike më të pasura në njerëzimin.

Faleminderit, *grua-e kushtuar!* Duke ndjekur shembullin e gruas më të madhe, Nënës së Krishtit, Fjalës së mishëruar, ke hapur veten me butësi dhe besnikëri ndaj Zotit, duke ndihmuar Kishën dhe të gjithë njerëzimin për të jetuar ndaj Perëndisë një përgjigje "nusërore", e cila shpreh mrekullisht bashkimin që Ai dëshiron të bëjë me krijesën e tij.

Faleminderit, *grua, për vetë faktin që je grua!* Me ndjeshmërinë tënde femërore, ti na ndihmon për të kuptuar botën dhe kontribuon që të kemi marrëdhënie me të vërtetë njerëzore.

[*Ungjilli i Krishtit dhe vështirësitë e historisë*]

3. Por nuk mjafton *faleminderit*, e di. Për fat të keq, ne jemi trashëgimtarë të një hi-

storie të kushtëzimeve shumë të mëdha, që në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet, e kanë vështirësuar ecjen e gruas, të cilës nuk i është njohur dinjiteti, në prerogativat e saj, shpeshherë e lënë mënjanë dhe e ka katandisur si skllave. Kjo ka penguar gruan që të jetë plotësisht vetvetja, dhe ka varfëruar gjithë njerëzimin nga pasuritë shpirtërore autentike. Nuk do të ishte e lehtë të përcaktonim kush e ka përgjegjësinë, duke pasur parasysh forcën e ndarjeve kulturore, që përgjatë shekujve kanë përcaktuar mentalitete dhe institucione... Nëse, në mbajtjen e këtyre përgjegjësisive, veçanërisht në disa kontekste të caktuara historike, këto përgjegjësi objektive nuk janë mbajtur edhe nga ana e shumë bijve të Kishës, unë po shpreh sinqerisht keqardhjen time. Ky peng duhet të prodhojë për të gjithë Kishën një angazhim të përtërirë për besnikërinë ndaj frymëzimit ungjillor. Sepse Ungjilli ka një mesazh gjithmonë aktual në temën e çlirimit të grave nga të gjitha format e shtypjes dhe zotërimit, që buron nga *vetë qëndrimi i Krishtit*. Duke kapërcyer zakonet në fuqi në kulturën e kohës së tij, Jezusi kishte ndaj

grave një qëndrim të hapur, plot respekt, pranim, butësi. Në këtë mënyrë ai e nderoi dinjitetin që gratë kanë pasur gjithmonë në projektin dhe në dashurinë e Hyjit. Duke parë Krishtin në fund të këtij mijëvjeçari të dytë, është e natyrshme të pyesim veten: a thua mesazhi i tij u dëgjua dhe u zbatua me të vërtetë?

Po, është koha për të parë, me guximin e kujtesës dhe me njohjen e sinqertë të përgjegjësiave, historinë e gjatë të njerëzimit, për të cilën gratë kanë kontribuar jo më pak se burrat, dhe në shumicën e kohës me kushte shumë më të vështira. Unë mendoj, në veçanti, për gratë që e donin kulturën dhe artin dhe u janë përkushtuar atyre duke nisur nga kushtet e pafavorshme, shpeshherë të përjashtuara nga arsimi i barabartë, të ekspozuara ndaj nënvlerësimit, të mosrespektimit dhe madje edhe shpronësimit të kontributit të tyre intelektual. Nga puna e shumëfishtë e grave në histori, për fat të keq, shumë pak ka mbetur e dukshme me mjetet e historiografisë shkencore. Për fat të mirë, nëse koha i ka varrosur gjurmët e dokumentuara, ne nuk mund të mos e vërejmë fluksin produktiv

në limfën e jetës që brumos ekzistencën e brezave që kanë ardhur deri tek ne. Njerëzimi ka një borxh të pallogaritshëm ndaj kësaj “tradite” të madhe të grave. Sa gra kanë qenë vlerësuar dhe vlerësohen akoma sot më shumë për pamjen e tyre fizike, sesa për vlerën e tyre, për profesionalizimin e tyre, për aftësitë e tyre intelektuale, për ndjeshmërinë e tyre të thellë dhe, në fund të fundit, për vetë dinjitetin e qenies së tyre!

[Kundër diskriminimit dhe promovimi i ndikimit të gruas]

4. Çfarë mund të themi edhe në lidhje me pengesat që në shumë vende të botës ende i pengojnë gratë të integrohen plotësisht në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike? Le të mendohet për dhuratën e amësisë, të cilës i detyrohet mbijetesja e njerëzimit, se si shpesh, jo vetëm ajo nuk vlerësohet si duhet, por madje penalizohet. S’ka dyshim, se shumë mbetet për t’u bërë, që një grua dhe një nënë të mos pësojnë diskriminim. Është urgjente që të fitohet kudo *barazia e vërtetë* e të drejtave perso-

nale dhe pra barazia e pagesës për një punë të barabartë, mbrojtja për nënat që punojnë, ecuri e barabartë në karrierë, barazia e bashkëshortëve në të drejtat e familjes dhe njohja e çdo gjëje që është pjesë për të drejtat dhe detyrat e qytetarit në një regjim demokratik.

Bëhet fjalë për një akt drejtësie, por gjithashtu një domosdoshmëri. Çështjet serioze që diskutohen, në politikën e së ardhmes, do të përfshijnë gjithnjë e më shumë rolin e gruas: koha e lirë, cilësia e jetës, migrimi, shërbimet sociale, eutanzia, droga, kujdesi shëndetësor, ekologjia, etj. Për të gjitha këto fusha prania sociale më e madhe e grave do të shfaqet e çmuar, sepse do të ndihmojë për të manifestuar kontradiktat e një shoqërie të organizuar vetëm mbi kritere të efikasitetit dhe të produktivitetit, dhe do të detyrojë që të rishikohen sistemet në dobi të proceseve më të njerëzishme që shënojnë “qytetërimin e dashurisë”.

5. Duke parë një nga aspektet më të ndjeshme të gjendjes së grave në botë, si mund të harrojmë historinë e gjatë dhe de-

graduate - edhe pse shpesh "nëntokësore" - të **abuzimeve** të kryera ndaj grave në fushën e seksualitetit? Në pragun e mijëvjeçarit të tretë nuk mund të mbetemi të pandjeshëm dhe të japim dorëheqjen ndaj këtij fenomeni. Është koha për të dënuar me forcë, duke krijuar instrumente legjislative të përshtatshme të mbrojtjes, format e *dhunës seksuale* që shpesh u referohen grave. Në emër të respektit për personin nuk mund të rrimë pa denoncuar kulturën e gjerë hedoniste dhe komerciale, e cila nxit shfrytëzimin sistematik të seksualitetit, duke shkaktuar që edhe vajza shumë të reja të bien në qarqet e korrupsionit dhe të detyrohen që t'i shesin trupat e tyre. Përballë një perversioni të tillë, çfarë vlerësimi të madh meritojnë gratë që, me një dashuri heroike për fëmijët e tyre, vazhdojnë një shtatzani që nis nga padrejtësia e marrëdhënieve seksuale të kryera me forcë; dhe kjo, jo vetëm në mjedisin e mizorive që fatkeqësisht ndodhin në kontekste të luftës (ende aq të shpeshta në botë), por edhe në situatat e mirëqenies dhe paqes, shpesh të korruptuar nga një kulturë e lejimit hedonist, ku lulëzojnë më të

lehtë trendet e maskilizmit agresiv. Në kushte të tilla, zgjedhja e abortit, e cila (edhe pse mbetet gjithmonë një mëkat i rëndë) para se të jetë një përgjegjësi e grave, është një krim që duhet t'i atribuohet burrave dhe bashkëpunimit të mjedisit rrethues.

[*Një apel i përzemërt*]

6. *Falënderimi* im ndaj grave bëhet kështu një *apel i përzemërt* që nga të gjithë, veçanërisht nga shtetet dhe institucionet ndërkombëtare, do të kryhet gjithçka është e nevojshme që gratë të rifitojnë respektin e plotë për dinjitetin e tyre dhe për rolin e tyre. Në këtë drejtim, unë duhet të shpreh admirimin tim për gratë me vullnet të mirë, të cilat janë përkushtuar për të mbrojtur dinjitetin e gjendjes femërore duke luftuar për të fituar të drejtat themelore sociale, ekonomike dhe politike, dhe që u dëftuan të guximshme në një kohë kur angazhimi i tyre konsiderohej një akt rebelimi, shenjë e mungesës së feminitetit, një manifestim i ekzibicionizmit, dhe madje edhe një mëkat!

Siç kam shkruar në *Mesazhin për Ditën*

Botërore të Paqes të vitit 1995, duke shikuar procesin e madh të çlirimit të grave, mund të thuhet se «kjo ka qenë një ecje e vështirë dhe komplekse dhe, nganjëherë, jo pa gabime, por në thelb pozitive, edhe pse ende e papërfunduar, për shkak të pengesave të shumta, të cilat qëndrojnë në vende të ndryshme të botës, pengojnë gratë që të njihen, të respektohen dhe të vlerësohen në dinjitetin e tyre të veçantë» (n. 4).

Ne duhet të vazhdojmë në këtë rrugë! Por unë jam i bindur se sekretin për të arritur përparimin e shpejtë në respektimin e plotë të grave dhe të identitetit të tyre përfshin jo vetëm ankesën, megjithëse të nevojshme, kundër diskriminimit dhe padrejtësive, por e, mbi të gjitha, një **projekt efektiv dhe i shndritur i promovimit**, i cili përfshin të gjitha fushat e jetës femërore: duke filluar nga një *vetëdije e përtërirë dhe universale e dinjitetit të grave*. Në njohjen e ndërjegjes, pavarësisht ndikimeve të shumta historike, na sjell vetë arsyeja, e cila kupton ligjin e Hyjit të gdhendur në zemrën e çdo njeriu. Por është mbi të gjitha Fjala e Zotit që na lejon të kuptojmë qartë *bazën antropologjike*, rrënjësore të dinjitetit

të gruas, duke na e zbuluar në planin e Perëndisë për njerëzimin.

[*Burrë e grua plotësohen nga njëri tjetri*]

7. Më lejoni pra, motra të dashura, që ta meditoj përsëri, së bashku me ju, pjesën madhështore të Shkrimit Shenjt, e cila paraqet krijimin e njeriut. Kjo faqe biblike thotë aq shumë për dinjitetin tuaj dhe për misionin tuaj në botë. Libri i Zanafillës flet për krijimin në mënyrë sintetike dhe me gjuhë poetike dhe simbolike, por thellësisht të vërtetë: "Hyji e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së tij; në imazhin e Perëndisë ai e krijoi: mashkull dhe femër i krijoi" (Zan 1,27). Akti krijues i Zotit zhvillohet sipas një projekti të saktë. Së pari, thuhet se njeriu është krijuar "në imazhin dhe ngjashmërinë e Perëndisë" (krh. Zan 1,26). Kjo shprehje e bën menjëherë të qartë *veçorinë e njeriut në lidhje me gjithë punën e krijimit*. Më pas thuhet se ai, që nga fillimi, është krijuar si "mashkull dhe femër" (Zan 1,27). Vetë Shkrimi siguron interpretimin e këtij fakti: njeriu, edhe pse ishte i rre-

thuar nga krijesat e panumërta të botës së dukshme, kupton se është i vetëm (krh Zan 2,20). Perëndia ndërhyr për ta nxjerrë nga kjo situatë vetmie: «*Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; unë do t'i bëj një ndihmë që t'i përgjajë atij*» (Zan 2,18). Prandaj, në krijimin e gruas, është gdhendur që nga fillimi *parimi i ndihmës*: ndihmë – vëreni mirë - jo e njëanshme, por *reciproke*. Gruaja është plotësuese e burrit, ashtu si edhe burri është plotësuesi i gruas: gruaja dhe burri *plotësojnë* njëri-tjetrin. Feminiteti tregon karakterin "njerëzor", ashtu si maskuliniteti, por me një mënyrë të vepruari të ndryshme dhe plotësuese.

Kur Zanafilla flet për "ndihmë", nuk i referohet vetëm fushës së *veprimit*, por edhe asaj të *qenies*. Feminiteti dhe maskuliniteti janë plotësues mes tyre, jo vetëm nga pikëpamja fizike dhe psikike, por edhe ontologjike. Vetëm falë dualitetit të "maskullores" dhe të "femërores" "njeriu" realizohet plotësisht.

[Një mision i përbashkët]

8. Pas krijimit të njeriut mashkull dhe femër, Perëndia u thotë të dyve: "*Mbushni tokën dhe nënshtrojeni atë*" (Zan 1,28). Jo vetëm Zoti ua jep fuqinë për të nxjerrë në dritë fëmijët për të përjetësuar racën njerëzore, por edhe *ua beson tokën si një detyrë, që të angazhohen t'i përdorin burimet e saj në mënyrë të përgjegjshme*. Njeriu, duke qenë i arsyeshëm dhe i lirë, thirret për të transformuar fytyrën e tokës. Në këtë detyrë, e cila është një punë esenciale e kulturës, *si burri ashtu edhe gruaja kanë përgjegjësi të barabartë që nga fillimi*. Duke qenë të thirrur për një reciprocitet bashkëshortor dhe të frytshëm, dhe duke pranuar detyrën e tyre të përbashkët për të ushtruar sundimin mbi tokë, gruaja dhe burri nuk gjenden as në një barazi statike dhe të padiferencuar, as në një ndryshim të pashmangshëm dhe konfliktual: marrëdhënia e tyre më e natyrshme, e cila korrespondon me Planin e Zotit, është "*uniteti i të dyve*", pra një «*uni-dualitet*» në marrëdhënie, që secilit i mundëson të përjetojë marrëdhënien e vet

ndërpersonale dhe reciproke si një dhuratë që të pasuron dhe të bën më përgjegjës.

Prej këtij "uniteti të të dyve" besohet nga Hyji jo vetëm vepra e lindjes dhe e jetës së familjes, por edhe vetë ndërtimi i historisë. Nëse gjatë Vitit Ndërkombëtar të Familjes, të mbajtur në vitin 1994, u përqendrua vëmendja mbi *gruan si nënë*, me rastin e Konferencës së Pekinit [1995] është mirë që të bëhemi të vetëdijshëm për kontributin e shumëllojshëm që gruaja ia dhuron jetës së shoqërive dhe kombeve të tëra. Ky është një kontribut i një natyre shpirtërore dhe kulturore, para së gjithash, por edhe socio-politik dhe ekonomik. Me të vërtetë, është shumë i madh borxhi që sektorë të ndryshëm të shoqërisë, shtetet, kulturat kombëtare dhe, në fund të fundit, përparimi i të gjithë racës njerëzore kanë ndaj kontributit të grave!

[Gruaja dhe përparimi i vërtetë]

9. Zakonisht, përparimi vlerësohet sipas kategorive shkencore dhe teknike; dhe madje edhe nga kjo pikëpamje kontributi i grave nuk mungon. Sidoqoftë, ky nuk

është dimension i vetëm i progresit, madje as nuk është ai kryesor. Më i rëndësishëm është *dimensioni social dhe etik*, i cili përfshin marrëdhëniet njerëzore dhe vlerat shpirtërore: në këtë dimension, që shpesh zhvillohet në një mënyrë që s'bie në sy, duke filluar me marrëdhëniet e përditshme mes njerëzve, sidomos brenda familjes, është pikërisht "*gjeniu [ose gjenialiteti] i gruas*" së cilës shoqëria i është kryesisht borxhli.

Në lidhje me këtë, do të doja të shpreh mirënjohjen e veçantë për gratë e angazhuara në fusha të ndryshme të *punës së arsimit*, edhe përtej familjes: kopshte për fëmijët, shkolla, universitete, agjencitë e shërbimeve sociale, famullitë, shoqatat dhe lëvizjet. Kudo ka nevojë për një punë formuese, mund të shihet gatishmëria e madhe e grave që angazhohen në marrëdhëniet njerëzore, sidomos në shërbim të më të dobtëve dhe më të pambrojturve. Në këtë punë ato shfaqin njëlloj *amësinë afektive, kulturore dhe shpirtërore*, me të vërtetë të paçmueshme për ndikimin që ka në zhvillimin e personit dhe për të ardhmen e shoqërisë. Dhe si të mos përmendim dëshminë e kaq shumë grave katolike dhe e

shumë bashkësive fetare të grave në kontinente të ndryshme: ato e kanë bërë arsimin, sidomos të vajzave dhe djemve, shërbimin e tyre kryesor. Si nuk mund të mendoj me mirënjohje për të gjitha gratë që kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në shëndetësi, jo vetëm në institucionet shëndetësore shumë të organizuara, por edhe në rrethana shumë të pasigurta, në vendet më të varfra të botës, duke dëshmuar gatishmëri që shpesh i çon në martirizim?

[Të zbulohet "gjeniu' i gruas"]

10. Prandaj unë shpresoj, motra fort të dashura, që do të reflektohet me kujdes mbi temën e "gjenit të gruas", jo vetëm për të njohur në të tiparet e një synimi të veçantë të Hyjit, që duhet të pranohet dhe të nderohet, por edhe për t'ia bërë gruas më shumë hapësirë në të gjithë jetën shoqërore, si dhe në jetën kishtarë [...]. Në lidhje me këtë subjekt unë vetë e kam trajtuar gjerësisht në Letrën apostolike *Mulieris dignitatem*, botuar në vitin 1988 ... I ftoj meshtarët që të reflektojnë mbi rolin e

rëndësishëm që luan në jetën e tyre gruaja, si nënë, si motër dhe si bashkëpunëtore në jetën apostolike. Ky është një tjetër dimension - ndryshe nga bashkëshortja, por gjithashtu e rëndësishme - e asaj "ndihme" që gruaja, sipas Zanafillës, është e thirrur për t'ia dhënë burrit.

Kisha e sheh në *Marinë shprehjen më të lartë të "gjeniut femëror"* dhe gjen në Të një burim frymëzimi të pashterrshëm. Maria e quajti veten "shërbëtorja e Zotit" (Lk 1,38). Duke iu bindur Fjalës së Perëndisë ajo ka pranuar thirrjen e saj të privilegjuar, por absolutisht jo të lehtë, si grua dhe nënë e familjes së Nazaretit. Duke u vënë në shërbim të Perëndisë, ajo gjithashtu e vendosi veten në shërbim të njerëzve: një *shërbim dashurie*. Pikërisht ky shërbim lejoi që ajo të kuptojë në jetën e saj përvojën e një "mbretërie" misterioze, por autentike. Jo rastësisht ajo thirret si "Mbretëresha e qiellit dhe e tokës". Kështu e thërrret gjithë bashkësia e besimtarëve; shumë kombe dhe popuj e thërrasin atë "Mbretëreshë". "*Mbretërimi*" i saj është të shërbejë! *Shërbimi i saj është "të mbretërojë"!*

Kështu, duhet të kuptohet autoriteti si

në familje ashtu edhe në shoqëri dhe në Kishë. E "mbretërimi" është zbulesa e thirrjes themelore të personit, si i krijuar në "imazhin" e Atij që është Zoti i qiellit dhe i tokës; njeriu i thirrur për të qenë në Krishtin bir i tij i adoptuar. Njeriu është krijesa e vetme në tokë «që Hyji e donte për veten e saj», dhe «që nuk mund të gjejë plotësisht vetveten, përveçse nëpërmjet një dhurimi të sinqertë të vetvetes» (Koncili Vatik. II, *Gaudium et spes*, n. 24).

Mu në këtë gjë qëndron "mbretërimi" amnor i Marisë. Meqë ajo u bë me tërë qenien e saj, një dhuratë për Birin, ajo bëhet edhe *dhuratë për bijtë dhe bijat e njerëzimit*. Ajo zgjon besimin e thellë të atyre që kthehen tek ajo për të fituar drejtimin nëpërshtigjet e vështira të jetës tek fati i tyre përfundimtar dhe transhendent. Drejt këtij *qëllimi përfundimtar* të gjithë vijnë përmes fazave të thirrjes së tyre, një qëllim që orienton angazhimin me kalimin e kohës si të burrit ashtu edhe të gruas.

[*Barazia e dinjitetit dhe dallim rolesh*]

11. Nëse shërbimi bëhet me liri, me reciprocitet dhe me dashuri, ai shpreh "mbretërimin" e vërtetë të njeriut; dhe në këtë perspektivë shërbimi mund të pranohen, por pa pasoja negative për gruan, *edhe një larmi të rolesh*, për aq sa kjo shumëllojshmëri nuk është rezultat i vendosjes arbitrare, por rrjedh nga veçantitë e qenies mashkullore dhe femërore. Është një çështje që ka zbatimin e vet specifik edhe brenda Kishës. Krishti – me zgjedhjen e lirë dhe sovrane, siç dëshmojnë qartë Ungjilli dhe tradita e vazhdueshme e Kishës – ua ka besuar vetëm burrave detyrën e të qenit një "ikonë" e fytyrës së tij si "bari" dhe "dhëndër" të Kishës nëpërmjet ushtrimit të meshtarisë; por kjo nuk zvogëlon rolin e gruas, ashtu siç nuk zvogëlon atë të anëtarëve të tjerë të Kishës, që nuk janë caktuar për shërbesën e shenjtë, pasi të gjithë bashkëndajnë në mënyrë të barabartë vetë dinjitetin e "priftërisë së përbashkët" në bazë të Pagëzimit. Këto dallime rolesh, në fakt, nuk duhet të interpretohet në dritën

e kategorive funksionale tipike në shoqëritë njerëzore, por me kriteret specifike të *ekonomisë sakramentale*, d.m.th. të mbarështimit hyjnor të "shenjave" që Zoti i zgjodhi lirisht për t'u bërë i pranishëm në mesin e njerëzve.

Për më tepër, pikërisht në vijën e kësaj ekonomie të shenjave, edhe nëse jashtë sferës sakramentale, "feminiteti", i përjetuar në modelin sublim të Marisë, nuk është më pak i rëndësishëm. Në fakt ekziston brenda "feminitetit" të gruas besimtare, dhe sidomos të asaj së "kushtuar", një lloj i "*profecisë*" specifike (krh. MD n. 29), një simbolizëm shumë i fuqishëm, si një "ikonicitet" [një gatishmëri për të përfaqësuar] i cili realizohet plotësisht në Marinë dhe shpreh mirë thelbin e Kishës si bashkësi e shenjtëruar me integritetin e një "*virgjëreshë*" që të jetë "*nusja*" e Krishtit dhe "*nëna*" e besimtarëve. Në këtë perspektivë të plotësisht "ikonik" të roleve mashkullore dhe femërore [së bashku] sjellin më mirë në dritë dy dimensione themelore të Kishës: aspekti "Marian" dhe aspekti "apostolik-Pjetrin" (MD n. 27.).

Nga ana tjetër...priftëria shërbestare

(pra "meshtaria"), sipas Krishtit, «nuk është një shprehje e sundimit, por e shërbimit». Është një detyrë urgjente për Kishën, në vetë-rinovimin e saj të përditshëm në dritën e Fjalës së Perëndisë, që ta vërë më shumë në provë këtë pohim mbi shërbimin; qoftë duke zhvilluar frymën e bashkimit dhe duke nxitur me kujdes të gjitha ato mjete të pjesëmarrjes, qoftë nëpërmjet respektit dhe vlerësimit të karizmave të panumërta personale dhe të komunitetit që Shpirti i Hyjit frymëzon për ndërtimin e bashkësisë së krishterë dhe në shërbim të njerëzve.

Në këtë fushë të madhe të shërbimit, historia e Kishës në këto dy mijëvjeçarë, pavarësisht nga pengesat e shumta, e ka njohur me të vërtetë "gjenialitetin e gruas", duke parë që dolën nga gjiri i saj gratë me madhështi të jashtëzakonshme, të cilat kanë lënë gjurmën e madhe dhe të dobishme të tyre në kohë. Mendoj për radhën e gjatë të martirëve, shenjtëreshave, mistikëve të shquar. Sidomos mendoj për Shën Katerinën e Sienës dhe Shën Terezën e Avilës, të cilave Papa Pali VI ua atribuoi titullin "mësuese" të Kishës. Dhe si të mos

kujtojmë shumë gra që, të shtyra nga besimi, u kanë dhënë jetë iniciativave me rëndësi të jashtëzakonshme shoqërore në shërbim sidomos të të varfërve? E ardhmja e Kishës në mijëvjeçarin e tretë me siguri nuk do të dështojë të regjistrojë manifestime të reja dhe të admirueshme të "gjenialitetit femëror".

[*Kah e vërteta e plotë rreth gruas*]

12. Pra, ju shihni, motra të dashura, sa arsye ka Kisha për të dëshiruar që...*e vërteta e plotë rreth gruas të dalë në dritë*. Vërtetë duhet të vendoset në dritën e duhur "*gjenialiteti i gruas*", jo vetëm duke marrë në konsideratë gratë e mëdha dhe të famshme që kanë jetuar në të kaluarën ose që janë bashkëkohëse tonat, por edhe ato gra të *zakonshme*, të cilat zbulojnë talentet e tyre femërore në shërbim të të tjerëve në jetën e tyre të përditshme. Në fakt, gruaja, në dhurimin e saj për të tjerët, në jetën e përditshme, pranon thirrjen e thellë të jetës së vet, ajo që ndoshta më shumë se burri, e sheh *njeriun*, sepse ajo sheh me zemër. Ajo e sheh atë në mënyrë të pavarur nga si-

steme të ndryshme ideologjike apo politike. Ajo e sheh atë në madhësinë dhe kufijtë e tij, dhe përpiqet ta takojë dhe ta *ndihmojë* atë. Kështu realizohet në historinë njerëzore plani themelor i Krijuesit, dhe del në pah vazhdimisht në shumëllojshmëri të thirrjeve, *bukuria* - jo vetëm fizike, por sidomos shpirtërore - që Hyji i ka dhuruar nga fillimi njeriut dhe veçanërisht gruas.

Ftoj bashkësitë kishtare për një falënderim të përzemërt Krijuesit dhe Shëlbuesit të botës për dhuratën e një të mire kaq të madhe siç është feminiteti ose misteri i gruas. Ai, në shprehjet e shumta të tij, i përket trashëgimisë së njerëzimit dhe të vetë Kishës.

Le të kujdeset Maria, Mbretëresha e dashurisë, për gratë dhe misionin e tyre në shërbim të njerëzimit, të paqes, dhe përhapjes së Mbretërisë së Perëndisë!

Me bekimin tim. Nga Vatikani, 29 qershor 1995, Solemniteti i Shenjtorëve Pjetri dhe Pali.

Nga Letra apostolike
«Mulieris dignitatem»

Mbi dinjitetin e gruas (1988)

[Personi - Bashkimi - Dhurata]

7. Duke depërtuar me mendim në tërësinë e përshkrimit të Zanafillës 2,18-25, dhe duke e interpretuar atë në dritën e të vërtetës mbi shëmbëllimin dhe përngjasimin me Hyjin (krh. Zan 1,26-27), mund të kuptojmë edhe më plotësisht se në çfarë qëndron karakteri personal i qenies njerëzore, falë të cilit të dy – burri dhe gruaja – janë të ngjashëm me Hyjin. Në të vërtetë, çdo njeri është në shëmbëlltim të Hyjit si krijesë racionale dhe e lirë, e aftë ta njohë dhe ta dojë Atë. Veç kësaj, lexojmë se njeriu nuk mund të ekzistojë “vetëm” (krh. Zan 2,18); mund të ekzistojë vetëm si “njësi e dy vetëve”, dhe pra në marrëdhënie me një person tjetër njerëzor. Bëhet fjalë për një marrëdhënie të ndërsjellë: të burrit ndaj gruas dhe të gruas ndaj burrit. Të qenit person në shëmbëllim dhe përngjasim të

Hyjit, pra, do të thotë edhe një ekzistencë në marrëdhënie, në lidhje me “unin” tjetër. Kjo i paraprin vetëzbulesës përfundimtare të Hyjit njini e trini: njësi e gjallë në bashkësinë e Atit, të Birit dhe të Shpirtit Shenjt.

Në fillim të Biblës këtë nuk e dëgjojmë ende të thuhet drejtpërdrejt. Krejt Besëlidhja e Vjetër është sidomos zbulesë e së vërtetës në lidhje me njininë dhe njësinë e Hyjit. Në këtë të vërtetë themelore mbi Hyjin Besëlidhja e Re do ta fusë zbulesën e misterit të pakuptueshëm të jetës intime të Hyjit. *Hyji*, i cili lejon që njerëzit ta njohin nëpërmjet Krishtit, është *njësi në Trini*: është njësi në bashkësi. Në këtë mënyrë hidhet një dritë e re edhe mbi atë përngjasim dhe shëmbëllim të njeriut me Hyjin, për të cilin flet *Libri i Zanafillës*. Fakti se njeriu, i krijuar burrë e grua, është shëmbëllim i Hyjit nuk do të thotë vetëm se secili prej tyre individualisht është i ngjashëm me Hyjin, si qenie racionale dhe e lirë. Do të thotë edhe se burri dhe gruaja, të krijuar si “njësi e dy vetëve” në njerëzimin e përbashkët, janë të thirrur që të jetojnë një bashkësi dashurie dhe në këtë

mënyrë të pasqyrojnë në botë bashkësinë e dashurisë që është në Hyjin, për të cilën tri Vetat duhen në misterin intim të së vetmes jetë hyjnore. Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt, një Hyj i vetëm për njësinë e hyjnisë, ekzistojnë si persona prej marrëdhënieve të pashqyrtueshme hyjnore. Vetëm në këtë mënyrë bëhet e kuptueshme e vërteta se Hyji në vetvete është dashuri (krh. 1 Gjn 4,16).

*Shëmbëllimi dhe përngjasimi i njeriut me Hyjin, i krijuar si burrë e grua (për analogjinë që mund të mendohet mes Krijuesit dhe krijesës), shpreh edhe “njësinë e dy vetëve” në njerëzimin e përbashkët. Kjo “njësi e dy vetëve”, që është shenjë e bashkimit ndërpersonal, tregon se në krijimin e njeriut është përfshirë edhe njëfarë ngjashmërie e bashkësisë hyjnore (“*communio*”). Ky përngjasim është përfshirë si cilësi e të qenit personal të të dyve, të burrit dhe të gruas, dhe njëkohësisht si një thirrje e një detyrë. Në shëmbëllimin dhe në përngjasimin me Hyjin, që gjinia njerëzore mban në vetvete që prej “fillimit”, është rrënjësor themeli i krejt “*ethos*”-it njerëzor: Besëlidhja e Vjetër dhe ajo e Re*

do ta zhvillojnë këtë “ethos”, kulmi i të cilit është *urdhërimi i dashurisë*²⁵.

Në “njësinë e dy vetëve” burri dhe gruaja janë të thirrur që prej fillimit jo vetëm që të ekzistojnë “pranë njëri-tjetrit” apo “së bashku”, por edhe janë të thirrur të ekzistojnë në mënyrë të ndërsjellë “për njëri-tjetrin”.

Kështu shpjegohet edhe domethënia e asaj “ndihme”, për të cilën flitet në Librin e Zanafillës (Zan 2,18-25): “*Do t’ia bëj një ndihmë që t’i përngjajë*”. Konteksti biblik lejon që ta marrim edhe në kuptimin se gruaja duhet “ta ndihmojë” burrin – dhe nga ana e tij ky duhet ta ndihmojë gruan – para së gjithash për shkak të faktit se të dy janë “persona njerëzorë”: gjë që, në njëfarë kuptimi, i lejon njërit dhe tjetrës që ta zbulojnë gjithmonë dhe përsëri, si edhe ta pohojnë kuptimin e tërësishëm të njerëzimit të tyre. Është e lehtë të kuptojmë se – në këtë plan themelor – bëhet fjalë për një “ndihmë” nga të dyja anët dhe për një “ndihmë” të ndërsjellë. Njerëzim do të thotë thirrje në bashkimin ndërpersonal. Teksti i Zanafillës 2,18-25 tregon se martesë është përmasa e parë dhe, në njëfarë kuptimi,

themelore e kësaj thirrjeje. Por nuk është e vetmja. Krejt historia e njeriut mbi tokë realizohet brenda kësaj thirrjeje. Në bazë të parimit të të qenit në mënyrë të ndërsjellë “për” tjetrin, në “bashkësinë” ndërpersonale, zhvillohet në këtë histori integrimi në vetë njerëzoren, të dashur prej Hyjit, ajo që është “mashkullore” dhe ajo që është “femërore”. Tekstet biblike, duke filluar prej *Zanafillës*, vazhdimisht na mundësojnë të rigjejmë tokën në të cilën i ka rrënjët e vërteta mbi njeriun, tokën e qëndrueshme dhe të pacenueshme në mes të shumë ndryshimeve të ekzistencës njerëzore.

Kjo e vërtetë i përket edhe *historisë së shpëtimit*. Në lidhje me këtë, është veçanërisht domethënëse një shprehje e Koncilit II të Vatikanit. Në kapitullin mbi “bashkësinë e njerëzve” të Kushtetutës baritore *Gaudium et spes*, lexojmë: «Zotëria Jezus, kur i lutet Atit që “të gjithë të jenë një gjë e vetme” (Gjn 17,21-22), duke na vënë përpara horizonte të paarrtshme për arsye njerëzore, na ka sugjeruar *njëfarë ngjashmërie* mes bashkimit të Vetave hyjnore dhe bashkimit të bijve të Hyjit në

të vërtetën dhe në dashurinë. Kjo ngjashmëri tregon se njeriu, i cili në tokë është e vetmja krijesë të cilën Hyji e ka dashur për vetveten, nuk mund ta rigjejë plotësisht veten e vet, përveçse nëpërmjet një dhurimi të singertë të vetvetes» [GS 24].

Me këto fjalë teksti konciliar e paraqet në mënyrë të përmbledhur tërësinë e të vërtetës mbi burrin dhe gruan – e vërtetë që përvijohet qysh në kapitujt e parë të *Librit të Zanafillës* – ashtu si vetë struktura mbartëse e antropologjisë biblike dhe të krishterë. *Njeriu* – si burrë ashtu edhe grua – është e vetmja qenie mes krijesave të botës së dukshme që Hyji Krijues “e ka dashur për veten e vet”: pra, është një person. Të qenit person do të thotë: të priresh nga realizimi i vetvetes (teksti konciliar flet për “rigjetje”), që nuk mund të kryhet përveçse “nëpërmjet një dhurimi të singertë të vetvetes”.

Model i këtij interpretimi të personit është vetë Hyji si Trini, si bashkësi Vetash. Të thuash se njeriu është krijuar në shëmbëllim dhe përngjasim të këtij Hyji do të thotë edhe se njeriu është i thirrur të ekzistojë “për” të tjerët, të bëhet dhuratë.

Kjo i përket çdo qenieje njerëzore, qoftë

grua qoftë burrë, të cilët e aktualizojnë këtë në veçantinë e njëres dhe tjetrit. Brenda këtij meditimi rreth dinjitetit dhe thirrjes së gruas, kjo e vërtetë mbi qenien njerëzore përbën *pikënisjen e domosdoshme*. Edhe *Libri i Zanafillës* lejon të dallohet, si një skicë e parë, ky karakter martesor i marrëdhënies mes personave, mbi terrenin e të cilës do të zhvillohet, nga ana e saj, e vërteta mbi amësinë, si edhe ajo mbi virgjërinë, si dy përmasa të veçanta të thirrjes së gruas në dritën e Zbulesës hyjnore. Këto dy përmbajtje do ta gjejnë shprehjen e tyre më të lartë në ardhjen e “plotësisë së kohës” (krh. Gal 4,4) në figurën e “gruas” së Nazaretit: Nënë-Virgjër.

* * *

[*Dhurata e nuses*]

27. Koncili II i Vatikanit ka përtërirë në Kishë vetëdijen e universalitetit të priftërisë. Në Besëlidhjen e Re ka vetëm një fli dhe vetëm një Prift: Krishti. Në këtë *priftëri të vetme marrin pjesë të gjithë të pagëzuarit*, si burrat ashtu edhe gratë, pasi duhet “ta kushtojnë trupin e tyre si fli të gjallë, të

shenjtë e të pëlqyeshme Hyjit (krh. Rom 12,1), ta dëshmojnë në çdo vend Krishtin dhe, t'i japin përgjigje gjithsecilit që kërkon arsyen e shpresës që është në ta" (krh. 1 Pjt 3,15)" [LG 10]. Pjesëmarrja universale në flinë e Krishtit, në të cilën Shëlbuesi ia ka kushtuar Atit tërë botën, dhe, në veçanti, njerëzimin, bën që të gjithë në Kishë të jenë "mbretëri priftërinjsh" (Zb 5,10; krh. 1 Pjt 2,9), pra të marrin pjesë jo vetëm në misionin priftëor, por edhe në atë profetik dhe mbretëror të Krishtit Mesi. Veç kësaj, kjo pjesëmarrje përcakton bashkimin organik të Kishës, si Popull i Hyjit, me Krishtin. Në të shprehet njëkohësisht "misteri i madh" i *Letrës drejtuar Efesianëve: Nusja e bashkuar me Dhëndrin e vet; e bashkuar sepse jeton prej jetës së tij; e bashkuar, sepse merr pjesë në misionin e tij të trefishtë (tria munera Christi); në një mënyrë të tillë që t'i përgjigjet me një "dhuratë të sinqertë" të vetvetes dhuratës së patregueshme të dashurisë së Dhëndrit, shëlbuesit të botës. Kjo u përket të gjithëve në Kishë, si grave ashtu edhe burrave, dhe u përket natyrisht edhe atyre që janë pjesëmarrës të "priftërisë shërbestare [pra*

meshtarisë]], që ka karakterin e shërbimit. Në fushën e “misterit të madh” të Krishtit dhe të Kishës të gjithë janë të thirrur të përgjigjen – si një nuse – me dhuratën e jetës së tyre ndaj dhuratës së patregueshme të dashurisë së Krishtit, që, si shëlbues i botës, është i vetmi Dhëndër i Kishës. Në “priftërinë mbretërore”, që është e universale, shprehet njëkohësisht dhurata e Nuses.

Kjo ka një rëndësi themelore për ta kuptuar Kishën në thelbin e vet, duke shmangur që t’i vishen Kishës – edhe në të qenit e saj “institucion” i përbërë prej qeniesh njerëzore dhe i përfshirë në histori – kritere kuptimi dhe gjykimi që nuk i përkasin natyrës së saj. Edhe pse Kisha ka një strukturë “hierarkike”, megjithatë kjo strukturë ka si synim të vetin shenjtërimin e gjymtyrëve të Krishtit. Shenjtëria pastaj matet sipas “misterit të madh”, në të cilin Nusja i përgjigjet me dhuratën e dashurisë dhuratës së Dhëndrit, dhe këtë e bën “në Shpirtin Shenjt”, sepse “dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona me anë të Shpirtit Shenjt që na u dhurua” (Rom 5,5). Koncili II i Vatikanit, duke përforcuar mësimin e

gjithë traditës, ka kujtuar se në hierarkinë e shenjtërisë *pikërisht "gruaja"*, Maria e Nazaretit, është "figurë" e Kishës. Ajo "u paraprin" të gjithëve në rrugën drejt shenjtërisë; në personin e saj "Kisha ka arritur përsosmërinë, me të cilën ekziston e panjollë dhe e parrudhë" (krh. Ef 5,27)" [LG 63, 65]. Në këtë kuptim mund të thuhet se Kisha është *njëkohësisht "mariane"* dhe "apostoliko-pjetrorë".

Në historinë e Kishës, që në kohët e para - pranë burrave - kishte edhe *shumë gra*, për të cilat përgjigjja e Nuses ndaj dashurisë shëlbuese të Dhëndrit merrte forcë të plotë shprehëse. Si të parat shohim ato gra, që personalisht e kishin takuar Kishtin, e kishin ndjekur dhe, pas largimit të tij, së bashku me apostujt "nuk mungonin në lutje" në çenakullin e Jerusalemit deri ditën e Rrëshajës. Atë ditë Shpirti Shenjt foli nëpërmjet "bijve dhe bijave" të Popullit të Hyjit, duke përmbushur kumtimin e Joelit profet (krh. Vap 2,17). Ato gra, dhe më pas edhe të tjera, qenë *pjesë aktive dhe të rëndësishme në jetën e Kishës së parë*, në ndërtimin që prej themeleve të bashkësisë së parë të krishterë - dhe

bashkësive të mëvonshme – *nëpërmjet karizmave dhe shërbimit të tyre shumëformësh*. Shkrimet apostolike shënojnë emrat e tyre, si Feba, “diakoneshë e Kenhreit” (krh. Rom 16,1), Priska grua e Akuilës (krh. 2 Tim 4,19), Evodia dhe Sintika (krh. Fil 4,2), Maria, Trifena, Persida, Trifoza (krh. Rom 16,6.12). Apostulli flet për “mundimet” e tyre për Krishtin, dhe këto tregojnë fushat e ndryshme të shërbimit apostolik të Kishës, duke filluar prej “kishës shtëpiake”. Në të vërtetë, në të “feja e çiltër” kalon prej nënës te bijtë dhe nipat, sikurse ndodhi në shtëpinë e Timoteut (krh. 2 Tim 1,5).

E njëjta gjë përsëritet gjatë shekujve, nga breznia në brezni, siç tregon *historia e Kishës*. Në të vërtetë, Kisha, duke mbrojtur dinjitetin e gruas dhe thirrjen e saj, ka shprehur nderim e mirënjohje për ato që – besnike ndaj Ungjillit – në çdo kohë kanë marrë pjesë në misionin apostolik të të gjithë Popullit të Hyjit. Bëhet fjalë për shenjte martire, për virgjëra, për nëna familjesh, që me guxim e kanë dëshmuar fenë e tyre dhe duke edukuar bijtë e tyre në shpirtin e Ungjillit, kanë përçuar fenë

dhe traditën e Kishës.

Në çdo epokë dhe në çdo vend gjejmë shumë gra “të përsosura” (krh. Fu 31,10), që – pavarësisht prej përndjekjeve, vështirësive dhe diskriminimeve – kanë marrë pjesë në misionin e Kishës. Mjafton të përmendim këtu Monikën, nënën e Agustinit, Makrinën, Olgën e Kievit, Matildën e Toskanës, Edvixhin e Slisisë dhe Edvixhin e Krakovias, Elizabetën e Turingjisë, Brixhidën e Suedisë, Zhan d’Arkën, Rozën e Limës, Elizabeta Setonin dhe Meri Uardin.

Dëshmia dhe veprat e grave të krishtera kanë pasur një ndikim të madh në jetën e Kishës, sikurse edhe në atë të shoqërisë. Edhe në prani të diskriminimeve të mëdha shoqërore gratë e shenjta kanë vepruar në “mënyrë të lirë”, të përforcuara prej bashkimit të tyre me Krishtin. Një bashkim dhe liri e tillë e rrënjosur në Hyjin shpjegojnë, për shembull, veprën e madhe të Shenjtes Katerinë nga Siena në jetën e Kishës dhe të Shenjtes Terezë të Jezusit në atë murgjërë.

Edhe në ditët tona Kisha nuk resht së pasuruari me dëshminë e shumë grave që

realizojnë thirrjen e tyre në shenjtëri. Gratë e shenjta janë një mishërim i idealit femëror, por janë edhe një model për të gjithë të krishterët, një model i “*sequela Christi*” (“ndjekjes së Krishtit”), një shembull se si Nusja duhet t’i përgjigjet me dashuri dashurisë së Dhëndrit.

* * *

[*Profetizmi i gruas: “ajo që merr dashurinë, për të dashur edhe vetë nga ana e saj”*]

29. Pjesa që kemi marrë nga *Letra drejtuar Efesianëve* (Ef 5,21-33), në të cilën marrëdhënia mes Krishtit dhe Kishës paraqitet si lidhje mes Dhëndrit e Nuses, i referohet edhe institucionit të martesës sipas fjalëve të *Librit të Zanafillës* (krh. Zan 2,24). Ajo e bashkon të vërtetën mbi martesën si sakrament të parë me krijimin e burrit dhe të gruas në shëmbëllim e përngjasim me Hyjin (krh. Zan 1,27; 5,1). Falë krahasimit domethënës që gjendet në *Letrën drejtuar Efesianëve* fiton qartësi të plotë ajo që vendos për *dinjitetin e gruas qoftë para syve të Hyjit, Krijues dhe Shëlbues,*

*qoftë para syve të njeriut: të burrit dhe të gruas. Në themelin e planit të amshuar të Hyjit, gruaja është ajo në të cilën rendi i dashurisë së botës së krijuar të personave gjen tokën për rrënjën e vet të parë. Rendi i dashurisë i përket jetës intime të vetë Hyjit, jetës trinitare. Në jetën intime të Hyjit, Shpirti Shenjt është hipostaza personale e dashurisë. Nëpërmjet Shpirtit, Dhuratës së pakrijuar, dashuria bëhet një dhuratë për personat e krijuar. *Dashuria, që është prej Hyjit, u komunikohet krijesave: "dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona me anë të Shpirtit Shenjt që na u dhurua"* (Rom 5,5).*

Thirrja në ekzistencë e gruas pranë burrit ("një ndihmë që t'i përngajë": Zan 2,18) në "njësinë e dy vetëve" ofron në botën e dukshme të krijesave kushte të veçanta që "dashuria e Hyjit të ndikohet në zemrat" e qenieve të krijuara në shëmbëllim të tij. Nëse autori i *Letrës drejtuar Efesianëve* e quan Krishtin Dhëndër dhe Kishën Nuse, ai, në mënyrë të tërthortë, me këtë analogji pohon të vërtetën mbi gruan si nuse. Dhëndri është ai që do. Nusja: është ajo që merr dashurinë, për

të dashur edhe vetë nga ana e saj.

Pjesa e *Zanafillës* – e rilexuar në dritën e simbolit martesor të *Letrës drejtuar Efesia-nëve* – na mundëson të dallojmë një të vërtetë që duket se vendos në mënyrë thelbësore çështjen e dinjitetit të gruas dhe, më pas, edhe atë të thirrjes së saj: *dinjiteti i gruas matet prej rendit të dashurisë*, që thelbësisht është rend drejtësie dhe dashurie [Sh. Agustini, *Trin.*, L. VIII,vii-x].

Vetëm personi mund t'i dojë të tjerët dhe vetëm personi mund të duhet prej të tjerëve. Ky është një pohim, para së gjithash, me natyrë ontologjike, prej të cilit rrjedh pastaj një pohim me natyrë etike. Dashuria është një kërkesë ontologjike dhe etike e personit. Personi duhet të duhet prej të tjerëve, pasi vetëm dashuria i përgjigjet asaj që personi është. Kështu shpjegohet *urdhri i dashurisë*, i njohur që në Besëlidhjen e Vjetër (krh. Lp 6,5; Lev 19,18) dhe i vënë prej Krishtit në vetë qendrën e "*ethos*"-it ungjillor (krh. Mt 22,36-40; Mk 12,28-34). Kështu shpjegohet edhe ajo *parësi e dashurisë* e shprehur prej fjalëve të Palit në Letrën drejtuar Korintianëve: "më e madhja është dashuria" (krh. 1 Kor 13,13).

Nëse nuk mbajmë parasysh këtë rend dhe këtë parësi, nuk mund t'i jepet një përgjigje e plotë dhe e përshtatshme pyetjes mbi dinjitetin e gruas dhe mbi thirrjen e saj. Kur themi se gruaja është ajo që merr dashuri për të dashur edhe ajo vetë nga ana e saj, nuk nënkuptojmë vetëm dhe para së gjithash marrëdhënien specifike bashkëshortore të martesës. Nënkuptojmë diçka më universale, të mbështetur në vetë faktin e të qenit grua në tërësinë e marrëdhënieve ndërpersonale, që në mënyrat më të ndryshme e strukturojnë bashkëjetesën dhe bashkëpunimin mes personave, burrave dhe grave. Në këtë kontekst, të gjerë dhe të larmishëm, *gruaja paraqet një vlerë të veçantë si person njerëzor dhe, në të njëjtën kohë, si ai person konkret, për faktin e të qenit të saj femër*. Kjo gjë i përket të gjitha grave dhe secilës prej tyre, pavarësisht prej kontekstit kulturor në të cilën secila gjendet dhe prej karakteristikave shpirtërore, psikike dhe trupore, si, për shembull, mosha, arsimi, shëndeti, puna, të qenit e martuar apo beqare.

Pjesa e *Letrës drejtuar Efesianëve* që po shqyrtojmë na lejon të mendojmë për

njëfarë “**profetizmi**” të veçantë të gruas në të qenit të saj femër. Analogjia e Dhëndrit dhe e Nuses flet për dashurinë me të cilën çdo njeri është i dashur prej Hyjit në Krishtin, çdo burrë dhe çdo grua. Megjithatë, në kontekstin e analogjisë biblike dhe në bazë të logjikës së brendshme të tekstit, është pikërisht gruaja ajo që ua shfaq të gjithëve këtë të vërtetë: nusen. Kjo karakteristikë “*profetike*” e gruas në të qenit e saj femër e gjen shprehjen më të lartë në Virgjëren Nënë të Hyjit. Në lidhje me të, në mënyrë më të plotë dhe të drejtpërdrejtë, vihet në dukje bashkimi intim i rendit të dashurisë – që hyn në fushën e botës së personave njerëzorë nëpërmjet një Gruaje – me Shpirtin Shenjt. Maria dëgjon në Lajmërim: “Shpirti Shenjt do të zbresë në ty” (Lk 1,35).

["Po ta dije ti çka të dhuron Hyji"]

31. "Po ta dije ti çka të dhuron Hyji" (Gjn 4,10), i thotë Jezusi Samaritanes gjatë njërës prej atyre bisedave të jashtëzakonshme që tregojnë se sa e vlerëson ai dinjitetin e çdo gruaje dhe thirrjen që i mundëson asaj të marrë pjesë në misionin e Mesisë.

Këto reflektime, të cilat arritën në fund, janë të orientuara për të njohur brenda "dhouratës së Hyjit" atë që Ai, krijues dhe shpërblyes, i beson gruas, çdo gruaje. Në të vërtetë, në Shpirtin e Krishtit ajo mund të zbulojë krejt domethënien e të qenit të saj femër dhe në këtë mënyrë të përgatitet për "dhurimin e sigurt të vetvetes" të tjerëve, e kështu "të gjejë" vetveten.

...Kisha dëshiron ta falënderojë Trininë e Shenjtë për "misterin e gruas", dhe, për çdo grua - për atë që përbën masën e amshuar të dinjitetit të saj femëror, për "punët e mëdha të Hyjit" që në historinë e breznive njerëzore janë bërë në të dhe nëpërmjet saj. Si përfundim, a nuk është

bërë në të dhe nëpërmjet saj gjithçka është më e madhe në historinë e njeriut mbi këtë tokë: fakti se vetë Hyji është bërë njeri?

Pra, *Kisha falënderon për të gjitha gratë dhe për secilën prej tyre: për nënat, motrat, bashkëshortet; për gratë e kushtuara Zotit në virgjëri; për gratë e kushtuara shumë e shumë qenieve njerëzore, që presin dashurinë falas të një personi tjetër; për gratë që kujdesen për qenien njerëzore në familje, që është shenja themelore e bashkësisë njerëzore; për gratë që punojnë profesionalisht, gra nganjëherë të rënduara prej një përgjegjësie të madhe shoqërore; për gratë “e përsosura” dhe për gratë “e dobëta”, për të gjitha: ashtu siç kanë dalë prej zemrës së Hyjit në të gjithë bukurinë dhe pasurinë e të qenit të tyre femër; ashtu siç janë përqaftuar prej dashurisë së tij të amshuar; ashtu sikurse, së bashku me burrin, janë shtegtare mbi këtë tokë, që, në kohë, është “atdheu” i njerëzve dhe nganjëherë shndërron në një “shekull plot me lot”; ashtu sikurse, së bashku me burrin, marrin përsipër një përgjegjësi të përbashkët për fatet e njerëzimit, sipas nevojave të përditshme dhe sipas atyre fateve përfundimtare që*

familja njerëzore ka në vetë Hyjin, në gjirin e Trinisë së patregueshme.

Kisha falënderon për të gjitha shfaqjet e “natyrës” femërore gjatë historisë, në mes të të gjithë popujve e Kombeve; falënderon për të gjitha karizmat që Shpirti Shenjt u jep grave në historinë e Popullit të Hyjit, për të gjitha fitoret që ajo ka arritur prej fesë, shpresës dhe dashurisë së tyre: falënderon për të gjitha frytet e shenjtërisë femërore.

Në të njëjtën kohë, Kisha kërkon që këto “shfaqje të Shpirtit” (krh. 1Kor 12,4 e vijim) që me bujari të madhe u janë dhënë “bijave” të Jerusalemit të amshuar, të njihen dhe të vlerësohen me vëmendje, që të jenë në dobinë e përgjithshme të Kishës dhe të njerëzimit, sidomos në kohët tona. Duke medituuar misterin biblik të “gruas”, Kisha lutet që të gjitha gratë të gjejnë në këtë mister vetveten dhe “thirrjen supreme” të tyre.

Maria, që “i paraprin gjithë Kishës në rrugën e fesë, të dashurisë dhe të bashkimit të përsosur me Krishtin” [LG 63], e fitoftë për të gjithë ne edhe këtë “fryt”.

PËRMBAJTJA

LETRA DREJTUAR GRAVE (1995)	5
<i>Falënderimi</i>	6
<i>Ungjilli i Krishtit dhe vështirësitë e historisë</i>	7
<i>Kundër dizkriminimit dhe promovimi i ndikimit të gruas</i>	10
<i>Një apel i përzemërt</i>	13
<i>Burrë e grua plotësohen nga njëri tjetri</i>	15
<i>Një mision i përbashkët</i>	17
<i>Gruaja dhe përparimi i vërtetë</i>	18
<i>Të zbulohet “gjeniu’ i gruas”</i>	20
<i>Barazia e dinjitetit dhe dallim rolesh</i>	23
<i>Kah e vërteta e plotë rreth gruas</i>	26
Nga Letra apostolike «Mulieris dignitatem» (1988)	28
<i>Personi – Bashkimi – Dhurata</i>	28
<i>Dhurata e nuses</i>	34
<i>Profetizmi i gruas</i>	40
<i>“Po ta dije ti çka të dhuron Hyji”</i>	45